



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA Durrës
KËSHILLI BASHKIAK**

VENDIM

Nr. 51, datë 09.07.2026

PËR MIRATIMIN E PËRDORIMIT TË FONDIT PREJ 694,220 (GJASHTËQIND E NËNTËDHJETË E KATËR MIJË E DYQIND E NJËZET) LEKË TË RIMBURSUARA NGA PROJEKTI TERRAIN, PROGRAMI INTERREG IPA ADRION (2021-2027)

Në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, Ligjit nr.68/2017, "Për financat e vetëqeverisjes vendore", Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Ligjit nr. 65/2022, "Për ratifikimin e Marrëveshjes Financiare Kuadër të Partneritetit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, dhe Komisionit Evropian për rregullat specifike të zbatimit të asistencës financiare të BE-së për Republikën e Shqipërisë në kuadër të Instrumentit për Asistencën e Paraanëtarësimit (IPA III)", Ligjit nr.73/2024, "Për ratifikimin e Marrëveshjes së Financimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, Republikës së Italisë, përfaqësuar nga Rajoni Emilia-Romagna, dhe Komisionit Evropian, për Programin Interreg (Interreg VI-B) IPA ADRION", Udhëzimit nr. 10, datë 12.07.2024, "Për kontrollin, regjistrimin, përdorimin, rakordimin, raportimin dhe publikimin e fondeve të financimeve të huaja në kuadrin e marrëveshjeve ndërkombëtare", Marrëveshjes së Partneritetit të nënshkruar më datë 15.11.2024 ndërmjet Partnerit Lider Centre for Research and Technology Hellas/Hellenic Institute of Transport dhe Bashkisë Durrës, për zbatimin e projektit "Twinning and Engagement in net-zero tRanport tRAnsItioN (TERRAIN)", të financuar nga Programi Interreg IPA ADRION 2021–2027, si dhe sipas relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Buxhetit, Drejtoria e Turizmit dhe Drejtoria Ekonomike, me propozim të Kryetares së Bashkisë,

**KËSHILLI BASHKIAK
V E N D O S I :**

1. Miratimin e përdorimit të fondit prej 694,220 lekë, të ardhura në llogari të projektit TERRAIN me kod produkti G107007, si rimbursim të shpenzimeve nga projekti.

2. Miratimin e shumës së rimbursuar për kryerjen e pagesave për blerjen dhe instalimin e pajisjeve TIC dhe 3 ekraneve led tek stacionet e autobusëve për zbatimin e planit pilot.
3. Ky fond të përdoret sipas të dhënave në Tabelën nr. 1, bashkëlidhur këtij vendimi, si pjesë përbërëse e tij.
4. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Turizmit, Drejtoria e Buxhetit, si dhe Drejtoria Ekonomike.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

KRYETARE
Denisa Luarasi



U shpall sot me datë 10.07.2026



Tabela nr.1

Gr.	Kap.	Programi	Llog. Ekon	Kodi i programit	Kodi i institucionit	Emri i institucionit	Emërtimi i projektit	Kodi i projektit	Fondi në lekë
00	2	Transporti publik	231	04570	2107001	Bashkia Durrës	Projekti TERRAIN	G107007	694,220




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT Durrës

Nr. 537/17 prot.

Durrës, më 15 . 07 .2026

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit



**KËSHILLIT BASHKIAK
DURRËS**

**KRYETARIT TË BASHKISË
DURRËS**

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.51 datë 09.07.2026 “Për miratimin e përdorimit të fondit prej 694,220 (gjashtëqind e nëntëdhjetë e katër mijë e dyqind e njëzet) lekë të rimbursuara nga projekti Terrain, program Interreg IPA Adrion (2021-2027).”

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut” i ndryshuar, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

**PREFEKTI
ADRIAN GURRA**

